**11.03.2023**
**Ora 11:08**

*RENDI I DITËS*

***Projektvendimi: "Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike "Partia Bindja Demokratike", për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023".***

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**

**1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve** — **Z. Ilirjan Celibashi**

**2. Stafi KQZ:** — **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja, Znj. P. Doçaj**

- **Parti Politike:** — **Partia "Bindja Demokratike"**
- **Të tjerë:** — **KRIIK**

***Z. I. Celibashi:*** Mirëmëngjes të gjithëve! Në seancën e sotme kemi në rend të ditës shqyrtimin e kërkesës së partisë "Bindja Demokratike", për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor pas afatit 24 orë që i dhamë për plotësimin e dokumentacionit bashkëshoqërues të kërkesës për regjistrim. Pika e dytë, shqyrtimin e kërkesës së partisë "Lëvizja për Zhvillim Kombëtar", për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e 14 majit 2023, vlerësuar kjo kërkesë pas vendimit për t'i dhënë 24 orë kohë këtij subjekti politik, për të plotësuar dokumentacionin bashkëshoqërues të kërkesës. Mandej vazhdojmë me projektvendim "Për plotësimin e vakancës në

Këshillin e Bashkisë Mat, në Këshillin e Bashkisë Dibër, në Këshillin e Bashkisë Kolonjë, në Këshillin e Bashkisë Shkodër. Kemi vlerësimin. Vlerësim i raportimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 24 shkurt – 2 mars 2023. Edhe e fundit nëqoftëse nuk gaboj është projektvendimi "Për shqyrtimin e kërkesës së qendrës mediatike MCA – Press & Gir për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023". Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesës së partisë "Bindja Demokratike", kemi dhënë 24 orë kohë për të bërë plotësimet dhe korigjimet e dokumentacionit që ka shoqëruar për kërkesën e këtij subjekti politik. Shkurt, nëse e keni plotësuar këtë kërkesë të vendimit të Komisionerit .

***Z. Y. Merkaj:*** Faleminderit, me vendimin nr. 155 datë 9.3.2023 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, ka kthyer për plotësim dokumentacioni regjistrimin e partisë politike "Bindja Demokratike" brenda afatit kohor.

***Z. I. Celibashi:*** E thamë këtë shkurt .

***Z. Y. Merkaj:*** Ka plotësuar dokumentacionin sipas nenit 64, pika 2 të Kodit Zgjedhor. Në këto kushte i kërkojnë Komisionit Zgjedhor regjistrimin e partisë " Bindja Demokratike", si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Faleminderit!

***Z. I. Celibashi:*** Dakord. Mirë faleminderit. Atëherë miratohet si…

***Z. F. Topollaj:*** Z.kryetar mundet, se kam diçka. Në fakt unë do i trajtoj të dyja se dhe rasti i LZHK-së është krejt i njëjtë. Përfaqësuesi i LZHK-së nuk është sot .

***Z. I. Celibashi***: Për formalitet procedurial, mbarojmë shqyrtimin e kërkesës së Bindjes dhe pastaj .

***Z. F. Topollaj:*** Dakord. Ne kemi bërë siç tha edhe përfaqësuesi i administratës. Kemi bërë plotësimin që na u kërkua nga ana juaj. Pra e kemi plotësuar edhe njëherë kërkesën për regjistrimin e partisë "Bindja Demokratike" dhe të partisë "LZHK" sipas kërkesa tuaja, pra duke ndryshuar respektivisht emrin e kryetarit të partisë dhe emrin e partisë në rastin e LZHK-së. Në gjykimin tonë vendimarrja juaj nuk ka qenë e saktë që na keni lënë këtyre dhe ne do të kërkonim sigurisht që të regjistroheshim sipas të dhënave që kemi deklaruar në kërkesën e parë sepse ne mendojmë që nuk jemi në kushtet që ka mangësi dokumentacioni. Maksimalisht jemi në kushtet që mendojmë që dokumentacioni ka qënë i plotësuar në mënyrë jo të saktë, pra me gabime dhe në këtë rast nuk ka mangësi dokumentacioni. Në këtë rast ju mund të merrnit vendimin nëse e gjykonit të arsyeshëm duke e shpallur vendimin me gabimet e korigjuara nga ana juaj. Rasti i plotësimit të dokumentacionit tipik është rasti që ju i latë Partisë Demokratike që një nga formularët nuk ishte plotësuar nga Kryetari i Partisë, ndërsa në rastin tonë ne nuk kemi lënë asnjë mangësi . Pra, ne në kërkesën për tu regjistruar kemi përcaktuar emrin e partisë politike siç është emri zyrtar që ne gjykojmë, që partia politike ka emër. Pra, në këtë rast nuk ka asnjë dokumtancion që mungon. Në këtë rast ka një dokumentacion që në gjykimin tuaj është i plotësuar në mënyrë të gabuar dhe ju maksimalisht mund të bënit një vendim për regjistrimin e parties, sipas të dhënave që ju gjykoni që janë të sakta dhe shembulli që ju i keni dhënë Partisë Demokratike në rastin e kërkesës për të plotësuar dokumentacionin që rasti i plotësimit të deklaratës së Kryetarit është si përgjegjësia e njeriut për të bërë ushtrinë nuk është e njëjtë në rastin tonë. Se ne e kemi bërë ushtrinë, ne e kemi plotësuar

kërkesën. Nuk e kemi bërë ushtrinë sipas gjykimit tuaj ashtu siç duhet bërë, por jo se ne nuk e kemi bërë ushtrinë dhe duhet të plotësonim dhe ndonjë mangësi për të kryer këtë gjë. Ju me të drejtë do të thoni se çfarë problem ka kjo apo ku ndryshon. Kjo në gjykimin tonë ndryshon thelbësisht sepse ju na keni kufizuar neve të drejtën për ankim, sepse ne duam të regjistrohemi në zgjedhje me emrin " Aleanca Progresiste LZHK", sepse në gjykimin tonë ky është emri i partisë që ne kemi dhe ju na e keni kufizuar këtë mundësi sepse Komisioni i Ankesave...

***Z. I. Celibashi:*** Po flasim për "Bindjen".

***Z. F. Topollaj:*** Dakord, po marr LZHK-në sepse është me thjeshtë se kazusi është njësoj. Nëse do flisnim për "Bindjen" do thonim që ne dimë që kemi kryetar partie X-in ndërsa ju na detyroni që të shkruajmë me dorën tonë që kemi Y-in, ndërkohë që ne jemi dakord të gjitha palët që kemi X-in. Prandaj po marr rastin e LZHK-së se është më e qartë si fabul, e thashë që në fillim . Edhe çfarë na ka ndodhur në këtë rast, na ka ndodhur që ju na keni kufizuar të drejtën për ankim sepse ne duam që të regjistrohemi me emrin që ne dimë se është emri zyrtar i partisë nga ana e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve. Në çastin tani që ne do vemi përpara KAS-it, Kas-i tani me të drejtë do të thotë që ju e keni plotësuar vetë këtë kërkesë me këtë emrin e ri, kështu që si po ankoheni për një gjë që e keni plotësuar vetë. Pra, na keni vënë përpara zgjedhjes që të djegësh jorganin për një plesht. Kështu që ne nuk mund ta djegim jorganin për një plesht dhe sigurisht e kemi plotësuar sipas kërkesës tuaj, por kjo nuk është mangësi dokumentacioni. Kjo mund të ishte në gjykimin tuaj, qameti, dokumentacion i plotësuar gabim dhe ju e korigjonit dhe thonit që emri i partisë nuk është " Aleanca Progresiste LZHK" por është "LZHK" dhe neve ankimonim këtë vendimarje, pra ankimonim faktin që na keni regjistruar me një

emër që ne nuk e dimë që është emri jonë zyrtar. Në këtë moment ne e kemi të kufizuar këtë të drejtë siç jua shpjegova pak më parë. Kështu që unë kërkoj që ju ta regjistroni " Bindjen Demokratike" dhe subjektin politik "LZHK' por të paktën në vendimin tuaj në pjesën arsyetuese ju të sqaroni që kërkesa jonë fillestare është që ne të regjistrohemi në zgjedhje me këto të dhena si subjekt zgjedhor në mënyrë që ne të kemi mundësi të ankimojmë faktin qe ju po na detyroni të regjistrohemi në zgjedhje me disa të dhëna që ne nuk mendojmë që janë të dhënat tona dhe janë të dhënat e sakta të partive tona në këtë rast. Faleminderit!

***Z. I. Celibashi:*** Faleminderit! Le të themi për momentin që argumenti juaj qëndron tërësisht . Unë jam i gatshëm t'a rikthej nga pikëpamja proceduriale situatën ku ishim përpara 24 orëve. Mjafton që ju të pranoni që ne nuk e kemi bërë plotësimin. Është në dorën tuaj e kërkesës e urdhërimit të Komisionerit për të bërë plotësimin e dokumentacionit, pasi ju e konsideroni thjesht një korrektim dhe këtë korrektim mund ta bëjë Komisioneri në vendimarrjen e tij që të mos humbisni të drejtën për tu ankuar në KAS sipas arsyetimit tuaj që për mua nuk ndryshon, por gjithsesi për sa kohë që nga pikëpamja ligjore për mua si Komisioner kjo nuk përbën asnjë lloj problemi, nëse i qëndroni atij pohimi unë jam i gatshëm të mos t'a konsideroj që ju e keni bërë këtë plotësimin. Po e regjistroj basuar në atë kërkesë sikurse ju thatë dhe ju të ankoheni në KAS. E pranoni kështu?

***Z. F. Topollaj:*** Pra, ju na regjistroni sipas kërkesës tonë fillestare ? Na regjistroni me kërkesën tonë fillestare por me të dhënat që ju i mendoni të sakta ?

***Z. I. Celibashi:*** Nëse ju e vlerësoni që kjo shkon për ju dhe kjo ju jep te drejtën..

***Z. F. Topollaj:*** Ju nuk vendosni që ne nuk e plotësuam dokumentacionin dhe na lini pa regjistruar .

***Z. I. Celibashi:*** Unë vlerësoj që ju keni konsideruar që kërkesa që urdhërimi që unë kam bërë për të plotësuar dokumentacionin nuk qëndron dhe ju vlerësoni që kërkesa është në përputhje me parashikimet e Kodit, sikurse ju e thatë dhe me këtë rast unë nuk i referohem kërkesës tuaj të ndryshuar, por i referohem kërkesës që ju keni sjellë dhe mund ta marrë edhe vendimin që ju doni.

***Z. F. Topollaj:*** Edhe merrni vendimin që une dua? Ok dakord, nëse behet kështu kjo është ajo që unë kërkoj.

***Z. I. Celibashi:*** Po qëllon që vendimi që ju doni, është edhe vendimi që unë dua, prandaj .

***Z. F. Topollaj:***: Ok, dakord. Po të kuptova.

***Z. I. Celibashi:*** Atëherë po e konsiderojmë në pohimin tuaj që nuk e keni plotësuar ose saktësuar sipas jush relacionin pasi nuk ka patur nevojë thoni ju

***Z. F. Topollaj:*** Nuk ka patur nevojë dhe kërkojmë që të regjistrohet me Kryetarin e Partisë që ne kemi deklaruar, pastaj nëse ju gjykoni që ka një kryetar tjetër partie ta regjistroni me kryetarin që gjykoni ju.

*Zbardhi materialin audio*
*Andoneta GJIKNURI*

***Z. I. Celibashi:*** Dakord, domethënë ajo çka u relatua këtu nga administrata formalisht nuk qëndron, sepse juve nuk keni patur asnjë arsye për të bërë korrektimin e të dhënave apo të saktësisë së dokumentacionit. Apo jo, kështu jemi? Edhe unë jam duke vlerësuar kërkesën e parë që ju keni paraqitur. Kështu jemi.

***Z. F. Topollaj:*** Po kështu jemi në varësi të vendimit të vendimarrjes tënde në vijim. Kjo historia që të mos djegim jorganin për një plesht. Pleshti ja vë zjarrin jorganit.

***Z. I. Celibashi:*** Nuk e gjej dot analogjinë në këtë çfarë thatë ju, në çfarë jeni duke diskutuar. Përtej kësaj vendimarrja do të jetë ajo që praktikisht e komunikova. Pra, regjistrimi i Bindjes sikurse janë të dhënat e pasqyruara në regjistrin e partive politike në Rrethin Gjyqësor Tiranë.

***Z. F. Topollaj:*** Faleminderit!

**Vendimi nr. 170**

**11.03.2023**

**Ora 11:21**

***RENDI I DITËS***

***<u>Projektvendim "Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Mat, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zj. Ana Gazmir Hysa".</u>***

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**

| | |
|---|---|
| **1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve** | **Z. Ilirjan Celibashi** |
| **2. Stafi KQZ:** | **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja, Znj. P. Doçaj** |
| • **Parti Politike:** | **Partia "Bindja Demokratike"** |
| • **Të tjerë:** | **KRIIK** |

***Z. I. Celibashi:*** Atëherë vazhdojmë me pikat e tjera të rendit të ditës që kanë të bëjnë me plotësimin e vakancave në disa këshilla bashkiak.

***Z. Y. Merkaj:*** Këshilli i Bashkisë Mat ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zoti Nezir Isuf Kolaveri, propozuar nga subjekti politik Partia Socialiste e Shqipërisë. Referuar nenit 164, paragrafi 2, i Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste, për Këshillin e Bashkisë Mat, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 16, zonja Ana Gazmir Hysa, e cila ka plotësuar e depozituar në Komisionin

Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit, me numër unik 11. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit konstatohet se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138 të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore ku në përgjigje të kërkesës sonë, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, ende nuk ka kthyer përgjigje, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore të kandidates për anëtarë të Këshillit të Bashkisë ku konstatohet se nuk është e dënuar me vendim penal të formës së prerë. Në këto kushte, mbështetur në pikën 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar të këshillit të Bashkisë Dibër, zonja Ana Gazmir Hysa nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e saj në funksionin e këshilltarit. Mbas kësaj kemi projektvendimin për shqyrtim dhe miratim. Faleminderit!

***Z. I. Celibashi:*** Mirë, dakord! Atëherë, bëjmë plotësimin e vakancës sipas projektvendimit të propozuar nga ana e administratës. Relatoji të gjitha meqenëse pak a shumë e njëjta…

***Z. Y. Merkaj:*** Keshilli i Bashkisë Dibër ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltarja, zonja Silvana Selim Lleshi, propozuar nga subjekti politik Partia G 99. Kandidati vijues nga lista shumemërore e kësaj partie, është kandidati me numër rendor 7, zoti Klodian Kapllan Përshaku, i cili ka depozituar formularin e vetëdeklarimit ku përcaktohet se nuk ka asnjë të dhënë e cila ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138, të vitit 2015. Pas kërkesës sonë për informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe Zyra e Gjendjes

Gjyqësore, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka kthyer përgjigje ku konstatohet se kandidati, zoti Klodian Kapllan Përshaku, nuk ka ndryshuar përbërësit e Gjendjes Civile. Gjithashtu, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ka dërguar verifikimin e Gjendjes Gjyqësore, ku konstatohet se nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë. Në këto kushte, këshilltari Klodian Përshaku nuk përbën kusht për moszgjedhjen e tij në funksionin e këshilltarit të Bashkisë Dibër. Gjithashtu Bashkia Kolonjë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për vakancën e krijuar nga këshilltari, zoti Edrion Luan Ajazi, propozuar nga Partia Demokracia Sociale. Kandidati vijues nga lista e kësaj partie të cilit i kalon mandati i këshilltarit është kandidati me numër rendor 03, zoti Arjan Andon Çikopana, i cili ka depozituar formularin e vetëdeklarimit, ku përcaktohet se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë e cila ka të bëjë me ndalimet në parashikimet në ligjin nr. 138, të vitit 2015. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ende nuk ka kthyer përgjigje kërkesës sonë për përbërësit e gjendjes civile, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ka dërguar verifikimin e Gjendjes Gjyqësore ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë. Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17 kandidati Arjan Andon Çikopana për kandidat të këshillit të Bashkisë Kolonjë, nuk përbën kusht për moszgjedhjen e tij në funksionin e këshilltarit. Gjithashtu këshilli i Bashkisë Shkodër, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zjonja Diandra Ferit Kraja, e cila ka dhënë dorëheqjen, propozuar nga subjekti politik Partia Social Demokrate. Kandidati vijues nga lista shumemërore e kësaj partie, është kandidati me numër rendor 14, zoti Durim Adem Bullakja i cili ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër unik 9. Nga verifikimi i këtij formulari konstatohet se nuk ka asnjë të dhënë që ka të bëjë

me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138, të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e Gjendjes Civile dhe nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore. Në përgjigje të kërkesës sonë, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, ka dërguar verifikimin e të dhënave ku konstatohet se emri ka ndryshuar nga "Durak" në "Durim", ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ka dërguar verifikimin e Gjendjes Gjyqësore ku konstatohet se nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë. Në këto kushte edhe ky kandidat nuk përbën kusht për moszgjedhjen e tij në funksionin e këshilltarit. Bashkangjitur kemi projektvendimin për shqyrtim dhe miratim. Faleminderit!

***Z. I. Celibashi:*** Mirë, faleminderit! Atëhere miratohet plotësimi i vakancave sipas draftit të propozuar, për Bashkinë Dibër, për Bashkinë Kolonjë, për Bashkinë Shkodër, dhe për Bahkinë Mat. Dakord, mirë!

**Vendimi nr.164**

**11.03.2023**

**Ora 11:24**

*RENDI I DITËS*

***Projektvendim "Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Dibër, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë G 99, z. Klodian Kapllan Përshaku".***

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**

**1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve** **Z. Ilirjan Celibashi**

**2. Stafi KQZ:** **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,**

- **Parti Politike:** **Partia "Bindja Demokratike"**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

*Z. I. Celibashi:* Atëherë, vazhdojmë me pikat e tjera të rendit të ditës që kanë të bëjnë me plotësimin e vakancave në disa këshilla bashkiakë.

***Z. Y. Merkaj:*** Këshilli i Bashkisë Mat ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zoti Nezir Isuf Kolaveri, propozuar nga subjekti politik Partia Socialiste e Shqipërisë. Referuar nenit 164, paragrafi 2, i Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste, për Këshillin e Bashkisë Mat, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 16, zonja Ana Gazmir Hysa, e cila ka plotësuar e depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit, me numër unik 11. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit konstatohet se nuk ka deklaruar asnjë të

dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138, të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore ku në përgjigje të kërkesës sonë, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, ende nuk ka kthyer përgjigje, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore të kandidates për anëtarë të Këshillit të Bashkisë ku konstatohet se nuk është e dënuar me vendim penal të formës së prerë. Në këto kushte, mbështetur në pikën 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar të këshillit të Bashkisë Dibër zonja Ana Gazmir Hysa nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e saj në funksionin e këshilltarit. Mbas kësaj kemi projektvendimin për shqyrtim dhe miratim. Faleminderit!

***Z. I. Celibashi:*** Mirë, dakord! Atëherë, bëjmë plotësimin e vakancës sipas projektvendimit të propozuar nga ana e administratës. Relatoji të gjitha meqenëse është pak a shumë e njëjta…

***Z. Y. Merkaj:*** Keshilli i Bashkisë Dibër ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltarja, zonja Silvana Selim Lleshi, propozuar nga subjekti politik Partia G 99. Kandidati vijues nga lista shumemërore e kësaj partie, është kandidati me numër rendor 7, zoti Klodian Kapllan Përshaku, i cili ka depozituar formularin e vetëdeklarimit ku përcaktohet se nuk ka asnjë të dhënë e cila ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138 të vitit 2015. Pas kërkesës sonë për informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe Zyra e Gjendjes Gjyqësore, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka kthyer përgjigje ku konstatohet se kandidati zoti Klodian Kapllan Përshaku, nuk ka ndryshuar përbërësit

e Gjendjes Civile. Gjithashtu, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ka dërguar verifikimin e Gjendjes Gjyqësore, ku konstatohet se nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë. Në këto kushte, këshilltari Klodian Përshaku nuk përbën kusht për moszgjedhjen e tij në funksionin e këshilltarit të Bashkisë Dibër. Gjithashtu Bashkia Kolonjë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për vakancën e krijuar nga këshilltari, zoti Edrion Luan Ajazi, propozuar nga Partia Demokracia Sociale. Kandidati vijues nga lista e kësaj partie të cilit i kalon mandati i këshilltarit është kandidati me numër rendor 03, zoti Arjan Andon Çikopana, i cili ka depozituar formularin e vetëdeklarimit, ku përcaktohet se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë e cila ka të bëjë me ndalimet në parashikimet në ligjin nr. 138, të vitit 2015. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ende nuk ka kthyer përgjigje kërkesës sonë për përbërësit e gjendjes civile, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ka dërguar verifikimin e Gjendjes Gjyqësore ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë. Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17, kandidati Arjan Andon Çikopana për kandidat të këshillit të Bashkisë Kolonjë, nuk përbën kusht për moszgjedhjen e tij në funksionin e këshilltarit. Gjithashtu këshilli i Bashkisë Shkodër, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zonja Diandra Ferit Kraja, e cila ka dhënë dorëheqjen, propozuar nga subjekti politik Partia Social Demokrate. Kandidati vijues nga lista shumemërore e kësaj partie, është kandidati me numër rendor 14, zoti Durim Adem Bullakja i cili ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër unik 9. Nga verifikimi i këtij formulari konstatohet se nuk ka asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138, të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e Gjendjes Civile dhe nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore.

Në përgjigje të kërkesës sonë, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, ka dërguar verifikimin e të dhënave ku konstatohet se emri ka ndryshuar nga "Durak" në "Durim", ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ka dërguar verifikimin e Gjendjes Gjyqësore ku konstatohet se nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë. Në këto kushte edhe ky kandidat nuk përbën kusht për moszgjedhjen e tij në funksionin e këshilltarit. Bashkangjitur kemi projektvendimin për shqyrtim dhe miratim. Faleminderit!

***Z. I. Celibashi:*** Mirë, faleminderit! Atëhere miratohet plotësimi i vakancave sipas draftit të propozuar, për Bashkinë Dibër, për Bashkinë Kolonjë, për Bashkinë Shkodër, dhe për Bahkinë Mat. Dakord, mirë!

**Vendimi nr.165**

**11.03.2023**

**Ora 11:25**

***RENDI I DITËS***

***<u>Projektvendim "Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Kolonjë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Demokracia Sociale, z. Arjan Andon Çikopana".</u>***

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**

| | |
|---|---|
| **1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve** | **Z. Ilirjan Celibashi** |
| **2. Stafi KQZ:** | **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja, Znj. P. Doçaj** |
| • **Parti Politike:** | **Partia "Bindja Demokratike"** |
| • **Të tjerë:** | **KRIIK** |

***Z. I. Celibashi****:* Atëherë vazhdojmë me pikat e tjera të rendit të ditës që kanë të bëjnë me plotësimin e vakancave në disa këshilla bashkiakë.

***Z. Y. Merkaj:*** Këshilli i Bashkisë Mat ka njoftuar Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zoti Nezir Isuf Kolaveri, propozuar nga subjekti politik Partia Socialiste e Shqipërisë. Referuar nenit 164, paragrafi 2, i Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste, për Këshillin e Bashkisë Mat, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër

rendor 16, zonja Ana Gazmir Hysa, e cila ka plotësuar e depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit, me numër unik 11. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit konstatohet se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138 të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore ku në përgjigje të kërkesës sonë, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, ende nuk ka kthyer përgjigje, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore të kandidates për anëtarë të Këshillit të Bashkisë ku konstatohet se nuk është e dënuar me vendim penal të formës së prerë. Në këto kushte, mbështetur në pikën 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar të këshillit të Bashkisë Dibër zonja Ana Gazmir Hysa nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e saj në funksionin e këshilltarit. Mbas kësaj kemi projektvendimin për shqyrtim dhe miratim. Faleminderit!

***Z. I. Celibashi:*** Mirë, dakord! Atëherë, bëjmë plotësimin e vakancës sipas projektvendimit të propozuar nga ana e administratës. Relatoji të gjitha meqënëse pak a shumë e njëjta…

***Z. Y. Merkaj:*** Keshilli i Bashkisë Dibër ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltarja, zj. Silvana Selim Lleshi, propozuar nga subjekti politik Partia G 99. Kandidati vijues nga lista shumemërore e kësaj partie, është kandidati me numër rendor 7, zoti Klodian Kapllan Përshaku, i cili ka depozituar formularin e vetëdeklarimit ku përcaktohet se nuk ka asnjë të dhënë e cila ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138 të vitit 2015.

Pas kërkesës sonë për informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe Zyra e Gjendjes Gjyqësore, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka kthyer përgjigje ku konstatohet se kandidati zoti Klodian Kapllan Përshaku, nuk ka ndryshuar përbërësit e Gjendjes Civile. Gjithashtu, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ka dërguar verifikimin e Gjendjes Gjyqësore, ku konstatohet se nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë. Në këto kushte, këshilltari Klodian Përshaku nuk përbën kusht për moszgjedhjen e tij në funksionin e këshilltarit të Bashkisë Dibër. Gjithashtu Bashkia Kolonjë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për vakancën e krijuar nga këshilltari, zoti Edrion Luan Ajazi, propozuar nga Partia Demokracia Sociale. Kandidati vijues nga lista e kësaj partie të cilit i kalon mandati i këshilltarit është kandidati me numër rendor 03, zoti Arjan Andon Çikopana, i cili ka depozituar formularin e vetëdeklarimit, ku përcaktohet se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë e cila ka të bëjë me ndalimet në parashikimet në ligjin nr. 138 të vitit 2015. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ende nuk ka kthyer përgjigje kërkesës sonë për përbërësit e gjendjes civile, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ka dërguar verifikimin e Gjendjes Gjyqësore ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë. Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17 kandidati Arjan Andon Çikopana për kandidat të këshillit të Bashkisë Kolonjë, nuk përbën kusht për moszgjedhjen e tij në funksionin e këshilltarit. Gjithashtu këshilli i Bashkisë Shkodër, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zonja Diandra Ferit Kraja, e cila ka dhënë dorëheqjen, propozuar nga subjekti politik Partia Social Demokrate. Kandidati vijues nga lista shumemërore e kësaj partie, është kandidati me numër rendor 14, zoti Durim Adem Bullakja i cili ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër unik 9. Nga verifikimi i këtij

formulari konstatohet se nuk ka asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138 të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e Gjendjes Civile dhe nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore. Në përgjigje të kërkesës sonë, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, ka dërguar verifikimin e të dhënave ku konstatohet se emri ka ndryshuar nga "Durak" në "Durim", ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ka dërguar verifikimin e Gjendjes Gjyqësore ku konstatohet se nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë. Në këto kushte edhe ky kandidat nuk përbën kusht për moszgjedhjen e tij në funksionin e këshilltarit. Bashkangjitur kemi projektvendimin për shqyrtim dhe miratim. Faleminderit!

***Z. I. Celibashi:*** Mirë, faleminderit! Atëherë miratohet plotësimi i vakancave sipas draftit të propozuar, për Bashkinë Dibër, për Bashkinë Kolonjë, për Bashkinë Shkodër, dhe për Bashkinë Mat. Dakord, mirë!

**Vendimi nr.166**

**11.03.2023**

**Ora 11:26**

*RENDI I DITËS*

***Projektvendim "Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Shkodër, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Social Demokrate të Shqipërisë, z. Durim Adem Bullakja ".***

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**

| | |
|---|---|
| **1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve** | **Z. Ilirjan Celibashi** |
| **2. Stafi KQZ:** | **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja, Znj. P. Doçaj** |
| • **Parti Politike:** | **Partia "Bindja Demokratike"** |
| • **Të tjerë:** | **KRIIK** |

***Z. I. Celibashi:*** Atëherë vazhdojmë me pikat e tjera të rendit të ditës që kanë të bëjnë me plotësimin e vakancave në disa këshilla bashkiakë.

***Z. Y. Merkaj:*** Këshilli i Bashkisë Mat ka njoftuar Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zoti Nezir Isuf Kolaveri, propozuar nga subjekti politik Partia Socialiste e Shqipërisë. Referuar nenit 164, paragrafi 2, i Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste, për Këshillin e Bashkisë Mat, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 16, zonja Ana Gazmir Hysa, e cila ka plotësuar e depozituar në Komisionin

Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit, me numër unik 11. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit konstatohet se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138, të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore ku në përgjigje të kërkesës sonë, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, ende nuk ka kthyer përgjigje, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore të kandidates për anëtarë të Këshillit të Bashkisë ku konstatohet se nuk është e dënuar me vendim penal të formës së prerë. Në këto kushte, mbështetur në pikën 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar të këshillit të Bashkisë Dibër zonja Ana Gazmir Hysa nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e saj në funksionin e këshilltarit. Mbas kësaj kemi projektvendimin për shqyrtim dhe miratim. Faleminderit!

***Z. I. Celibashi:*** Mirë, dakord. Atëhere bëjmë plotësimin e vakancës sipas projektvendimit të propozuar nga ana e administratës. Relatoji të gjitha meqënëse pak a shumë e njëjta...

***Z. Y. Merkaj:*** Keshilli i Bashkisë Dibër ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltarja, zonja Silvana Selim Lleshi, propozuar nga subjekti politik Partia G 99. Kandidati vijues nga lista shumemërore e kësaj partie, është kandidati me numër rendor 7, zoti Klodian Kapllan Përshaku, i cili ka depozituar formularin e vetëdeklarimit ku përcaktohet se nuk ka asnjë të dhënë e cila ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138 të vitit 2015. Pas kërkesës sonë për informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe Zyra e Gjendjes

Gjyqësore, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka kthyer përgjigje ku konstatohet se kandidati zoti Klodian Kapllan Përshaku, nuk ka ndryshuar përbërësit e Gjendjes Civile. Gjithashtu, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ka dërguar verifikimin e Gjendjes Gjyqësore, ku konstatohet se nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë. Në këto kushte, këshilltari Klodian Përshaku nuk përbën kusht për moszgjedhjen e tij në funksionin e këshilltarit të Bashkisë Dibër. Gjithashtu Bashkia Kolonjë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për vakancën e krijuar nga këshilltari, zoti Edrion Luan Ajazi, propozuar nga Partia Demokracia Sociale. Kandidati vijues nga lista e kësaj partie të cilit i kalon mandati i këshilltarit është kandidati me numër rendor 03, zoti Arjan Andon Çikopana, i cili ka depozituar formularin e vetëdeklarimit, ku përcaktohet se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë e cila ka të bëjë me ndalimet në parashikimet në ligjin nr. 138, të vitit 2015. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ende nuk ka kthyer përgjigje kërkesës sonë për përbërësit e gjendjes civile, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ka dërguar verifikimin e Gjendjes Gjyqësore ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë. Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17 kandidati Arjan Andon Çikopana për kandidat të këshillit të Bashkisë Kolonjë, nuk përbën kusht për moszgjedhjen e tij në funksionin e këshilltarit. Gjithashtu këshilli i Bashkisë Shkodër, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zonja Diandra Ferit Kraja, e cila ka dhënë dorëheqjen, propozuar nga subjekti politik Partia Social Demokrate. Kandidati vijues nga lista shumemërore e kësaj partie, është kandidati me numër rendor 14, zoti Durim Adem Bullakja i cili ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër unik 9. Nga verifikimi i këtij formulari konstatohet se nuk ka asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për

ndalime në ligjin nr. 138, të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e Gjendjes Civile dhe nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore. Në përgjigje të kërkesës sonë, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, ka dërguar verifikimin e të dhënave ku konstatohet se emri ka ndryshuar nga "Durak" në "Durim", ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ka dërguar verifikimin e Gjendjes Gjyqësore ku konstatohet se nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë. Në këto kushte edhe ky kandidat nuk përbën kusht për moszgjedhjen e tij në funksionin e këshilltarit. Bashkangjitur kemi projektvendimin për shqyrtim dhe miratim. Faleminderit!

***Z. I. Celibashi:*** Mirë, faleminderit! Atëhere miratohet plotësimi i vakancave sipas draftit të propozuar, për Bashkinë Dibër, për Bashkinë Kolonjë, për Bashkinë Shkodër, dhe për Bashkinë Mat. Dakord, mirë!

**Vendimi nr.167**

**11.03.2023**

**Ora 11:27**

***RENDI I DITËS***

***Projektvendim "Vlerësim i raportimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 24 shkurt – 2 mars 2023".***

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**

| | |
|---|---|
| **1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve** | **Z. Ilirjan Celibashi** |
| **2. Stafi KQZ:** | **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja, Znj. P. Doçaj** |
| • **Parti Politike:** | **Partia "Bindja Demokratike"** |
| • **Të tjerë:** | **KRIIK** |

***Z. I. Celibashi:*** Vlerësimi i veprimtarisë për institucionet publike për periudhën 24 shkurt-2 mars 2023.

***Znj. M. Koja:*** Atëherë Komisioner, në përfundim të periudhës së vlerësimit të raportimeve për veprimtaritë me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 24 shkurt-2 mars 2023, janë monitoruar 319 veprimtari, nga 72 institucione. Siç u raportua dhe herën e kaluar në seancën e kaluar, 57 prej këtyre veprimtarive nuk janë në përmbushje të afatit. Gjatë komunikimit dhe hetimit të rastit me institucionet, konkludohet se rrethanat dhe faktet e paraqitura prej tyre nuk janë, të themi, në kushtet e një mungese vullneti nga ana e tyre për të përmbushur detyrimin ligjor dhe

në këto kushte ne propozojmë pushimin e procedimit administrativ për këto institucione: Ministria e Buqësisë dhe e Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Kulturës, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët,Banka e Shqipërisë, Agjensia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësisë, Agjensia Shtetërore e Kadastrës, Prefekti i Qarkut Tiranë, Autoriteti i Aviacionit Civil, Qendra Kombëtare e Biznesit, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Korçë, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Fier, dhe Bashkitë Tiranë, Belsh, Dibër, Divjakë, Durrës, Gjirokastër, Kavajë, Korçë, Lezhë, Malësi e Madhe, Maliq, Mallakastër, Patos, Pogradec, Rrogozhinë, Sarandë dhe Tepelenë. Faleminderit!

***Z. I. Celibashi:*** Faleminderit! Tani me këtë historinë, probleme me aksesin e komunikimit, ne mund të vazhdojmë pafundësisht. Le të marrim një vendim tani e tutje për këtë çështje, dhe të hetohet pastaj, është problemi i sistemit tonë, është problemi i tyre në lidhje me aksesin e të tjera si këto, por në çdo rast në vijim nëse do ta konstatojmë tashmë qoftë edhe për një ditë, meqenëse e kemi bërë sqarimin se kur përfundon afati 5 ditor, le të vendosim qoftë edhe formalisht ndalimin e këtyre veprimtarive, pastaj nëse ka kundërshtime të ndjekim rrugën proceduriale.

**Vendimi nr.168**

**11.03.2023**
**Ora 11:30**

***RENDI I DITËS***

***<u>Projektvendim "Për shqyrtimin e kërkesës së qendrës mediatike MCA – Press & Gir për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023".</u>***

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**

| | |
|---|---|
| **1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve** | **Z. Ilirjan Celibashi** |
| **2. Stafi KQZ:** | **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja, Znj. P. Doçaj** |
| • **Parti Politike:** | **Partia "Bindja Demokratike"** |
| • **Të tjerë:** | **KRIIK** |

***Z. I. Celibashi:*** Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, me shqyrtimin e kërkesës të Qendrës Mediatike MCA – Press & Gir për të kërkuar akreditimin e disa vëzhguesve, për zgjedhjet e datës 14 maj 2023.

***Z. Y. Merkaj:*** Qendra Mediatike MCA – Press & Gir ka kërkuar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën dhe relacionin për akreditimit e gazetarëve për vëzhgimin e tyre. Kërkesa është respektuar në afatin e përcaktuar në nenin 6, pika 5 e Kodit Zgjedhor dhe plotëson gjithë dokumentacionin e parashikuar në pikën 2 të këtij neni. Për këtë i propozojmë Komisionerit Shtëtëror të Zgjedhjeve të bëjë akreditimin e përfaqësuesve. Faleminderit!

***Z. I. Celibashi:*** Mirë, atëherë miratohet kërkesa e Qendrës Mediatike MCA – Press & Gir për akreditimin e disa vëzhguesve për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Çështje të tjera në rendin e ditës? Nuk kemi .

Mirë e mbyllim seancën, faleminderit!

**Vendimi nr. 169**